

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim

Rapor tre mujor janar-mars 2023

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative, në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, gjatë kësaj periudhe 3 mujore kanë arritur 252 kërkesa me shkrim nga qytetarët dhe të gjitha janë shqyrtuar dhe miratuar brenda afatit ligjorë.

II. Transporti

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urbano - periferik me autobus dhe taksi, brenda territorit të saj, gjatë 3 muajve të parë janë lëshuar: 16 leje për operim auto - taksi në territorin e Komunës së Gjilanit.

III. Të hyrat financiare : në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim - gjatë kësaj periudhe janë realizuar të hyra financiare në vlerë, (shih tabelën 3.3):

Nr.	Përshkrimi i të hyrave nga	Vlera (euro)
1	Infrastrukturë	€ 6,156.54
2	Qiratë	€ 14,302.24
3	Tërheqje	€ 2,500.00
4	Taksa Rrugore	€ 53,105.00
	GJITHSEJ	€ 76,063.78

IV. Shpenzimet – ndaj operatorëve për punët e kryera gjatë vitit 2022-2023, që janë proceduar për pagesë gjatë tre muajve të parë 2023, janë: **204,782.47€**

V. Tërheqja e automjeteve me merimangë nga parkingjet ilegale, ka tërhequr 75 automjete.

VI. Projektet – (Kontratat që kanë vazhduar nga vitet paraprake) janë:

2.1 Ofrimi i shërbimeve të varrimit - Grupi i Operatorëve Ekonomik/Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjilan ``BEREQETI`` N.SH.T, Kontrata Publike Kornizë, Nr. Identifikimit GL 652-21-3707-2-1-1; shërbimet janë kryer konform kontratës dhe pozicioneve të parapara në të.

3.Mirëmbajtja dimërore e rrugëve : operatori. SH.P.K «EL-BAO», Kontratë Pune, Nr. Identifikimi : GL 651-22-9380-2-2-1/C415, meqë gjatë kësaj periudhe që po raportojmë ka pasur të reshura bore (pak) dhe është dashtë të intervenohet në mëngjes për shkak të ngricave që janë krijuar në zonat urbane dhe rurale si në zonën e malësisë së Zhegovcit, të Karadakut dhe Pogradit, Bilinicë, Caparë.

4. Operatori ekonomik “El-Bau” SH.p.k “Mirëmbajtja verore e rrugëve” nr. 651-21-34922. Nuk është intervenuar askund për shkak të sezonës dimërore.

5. Intervenimi nga KRU. “ **HIDROMORAVE** “ Gjilan:
Është intervenuar në rr. “Avdulla Tahiri” dhe rr. “A. Presheva” për shkak të pëlcitjes së gypit të ujësjellësit – sipas kërkesës urgjente nga KRU “Hidromorava”.

VI. Projekti : “Rregullimi dhe hapja e rrugëve të rendit të tretë, Pastrimi i lumenjve, Menaxhimi i deponisë dhe Largimi i deponive të Egra” me nr: 651-21- 4819-5-2-1,
Është intervenuar në rrafshimin dhe shtruarjen e rrugës me zhavorr në fshatin Dunav

VII. Ndriçimi publik në qytet: grupi i operatorëve ekonomik SH.P.K “EL-BAO” me nr. 651-20-7966-2-1-1 për ndriçimit publik në qytet - ka intervenuar sipas nevojës dhe kërkesave të qytetarëve.
Për sanimin e rrjetit ekzistues, kurse zgjerim të rrjetit të ri është bërë në Porodinë, Kodra e Dëshmorëve.

XI. Ndriçimi publik në fshatra, grupi i Operatorëve Ekonomik N.T.P i Toni - Goni: EL-BAO, SH.P.K : EING COM SH.P.K., F.SH. Malishevë Gjilan, Kontrata Publike Kornizë Nr. Identifikimi: 651-21-5456-1-1-1, ka intervenuar pas identifikimit nga zyrtarët përgjegjës dhe sipas kërkesave të banorëve është bërë sanimi në rrjetit ekzistues. Zgjerim ka pasur vetëm në fshatin Livoq i Ulët, Verbicë e Zhegocit dhe Llashticë.

• **Auditimi i Brendshëm** – (gjate muajit Shkurt)

Ka bërë auditimin e brendshëm në DSHPIB dhe kemi pasur takime të përditshme, konsultime, sugjerime, ofrimi i dosjeve dhe dokumenteve të kërkuara duke filluar nga Manuali, Organogrami i DSHPIB-së e deri te lëndët e ndryshme me peshë (me pagesë për qiranë, hapësira publike) të cilat janë dërguar edhe në gjykatë.

- **Zyra e Auditimit i Kombëtar** - në muajin shkurt 2 javë radhazi jemi angazhuar po ashtu është kërkuar kompletimi, skanimi dhe dërgimi i kopjeve për 19 subjekte afariste që kanë borxh, për llogaritë e Arkëtueshme mbi Qiranë. Për 8 lëndë ju kam ofruar shkresat e lëndëve sipas kërkesës së auditimit dhe posedimit të dokumenteve në arkivin e DSHPIB-së. Për 11 lëndë tjera nuk kemi pasur informata dhe dokumentacione me i ofrua, sepse kanë qenë lëndë nga viti 2000 e kënde.
- Po ashtu janë kërkuar nga zyrtarët tanë dosjet dhe lëndët ku të njëjtit kanë qenë menaxher apo mbikëqyrës të projekteve që janë realizuar sipas kontratave. Zyrtarët e DSHPIB-se ju kanë përgjegjësi sipas kërkesave për sigurimin e këtyre dosjeve.

- *Gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportojmë kemi filluar projektin :*

- 1- Projekti “Parku Baja”,
- 2- Projektin Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Jonuz Tërstena”
- 3- Projektin Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Livadhe e Arapit”
- 4- Si dhe janë përfunduar 5 terrenet sportive
 - 1- Në Shkollën « Sadullah Bretovci” Gjilan
 - 2- Në shkollën ‘Njazi Osmani’ Kishnapole
 - 3- Në shkollën” Skënderbeu” Verbicë e Kmetovcit
 - 4- Në shkollën shkollën “Fetah Qerimi” Verbicë e Zhegocit
 - 5- Në shkollën “Bajram Curri” Shurdhan
- 5- Është duke u përfunduar nga i viti i kaluar dhe një rrugë në lagjen e Vishnjave sa ka qenë 9.
- 6- Po ashtu janë duke punuar për ndërtimin e tri rrugëve të mbetura viti i kaluar në lagjen “Arbëria” dhe pritet të fillojnë punimet pasi është përgatitur rruga në lagjen Porodin dhe ka mbetur vetëm asfaltimi në ditët në vijim.

o *Gjatë kësaj kohe është punuar dhe shtrirë rrjeti i kanalizimit në :*

Fshatin Livoq të ulët, në lagjen e Zabelit, lagjen e Arbërisë, Fidanishte, në një gjatësi rreth 1700m. dhe është duke vazhduar me shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në fshatin Zhegër në gjatësi 400m.

Aktivitetet e publikuara në Prokurim të cilat janë në procedurat e tenderimit dhe kontraktimit janë 22 aktivitete, të gjitha projektet e investimeve kapitale ku 6 prej tyre janë nga marrëveshjet për bashkëfinancim nga Mi .

VIII. Takime

	<i>Emërtimi i Projektit</i>	<i>Vlera e projektit</i>	<i>Data publikimit</i>	<i>Afati dorëzimit të kërkesës pjesëmarrje</i>
1	Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në Komunën e Gjilanit.	340,000.00 €	24.02.2023	06.03.2023
2	Rregullimi i Trotuarit dhe ndriçimit Haxhaj-Demiraj.	179,000.00 €	28.02.2023	20.03.2023
3	Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit: • LOT 1-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Malishevë e Ulët, faza e dytë; • LOT 2- Asfaltimi i rrugëve “Qefsere Salihu” dhe “Blerim Halili”; • LOT 3- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Burnicë; • LOT 4- Asfaltimi i rrugëve në lagjen “Vishnjat”, pjesa e dytë.	917,856.00 €	22.08.2023	03.04.2023
4	Ndriçimi Publik në rrugën e Cërnicës	39,437.68 €	15.03.2023	04.04.2023
5	Asfaltimi i rrugëve lidhëse me rrugën qarkore	208.902,00 euro	28.03.2023	07.07.2023
6	Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë	480,000.00	10.04.2023	18.04.2023
7	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikes në rrugën “Adem Jashari”	187,049.13	05.04.2023	18.04.2023
8	Asfaltimi dhe ndërtimi i trotuarit Uglar	140,783.08	10.04.2023	24.04.2023
9	Hartimi i projektit integruar të sheshit, Parkingut nëntokësor dhe objekteve të administratës	200,00.00	07.04.2023	12.05.2023
10	Ndërtimi i rrjetit fekal dhe atmosferik Dheu i Bardh	66,575.00	10.04.2023	28.04.2023
11	Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjilanit-Lot 1 deri Lot 3; Lëndët e prokurimit-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lipovicë, Depcë, Muçibabë, Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balancë-Kravaricë, Asfaltimi i rrugëve “Vaqe Zela” dhe Hetë Koka”	535,557.65	06.04.2023	09.05.2023
12				

Kemi mbajtur takim pune me komisionin i cili është caktuar nga Kryetari i komunës për hartimin e planit regjional për menaxhimin e mbeturinave me Gizin-Gjerman dhe komunat e regjionit të anamoravës.

Kemi zhvilluar takime me policinë e trafikut, ku kemi diskutuar rreth sigurisë rrugore dhe masat që duhet të ndermirren për të ofruar siguri për të gjithë qytetarë që lëvizin në rrugët e territorit të komunës.

- Me Policinë e Kosovës, KRU Hodromorava, ECO- Higjienën
- Përfaqësuesit e Operatorëve ekonomik,
- Takime me përfaqësues të bizneseve dhe qytetarë

Me respekt!